



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-32749/22 datë:22.11.2022



Npi – 01/393 datë: 24.11.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 24.11.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 24.11.2022 (e enjte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë Kryesuesi z.Bajram Ilazi, Zëvendës Kryesuesi z.Muhamet Mehmeti, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Arton Demiri, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveq anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: znj.Valmira Hoxha - praktikante.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 28.10.2022,
2. Përfshirja e komuniteteve në projektet kulturore, sportive dhe rinore (Të ftohet DKRS),
3. Formimi i komisionit për hartimin e Planit-Punues për vitin 2023,
4. Diskutim për mundësinë e përfshirjes të një gruaje nga Komunitetet jo shumicë në Grupin Jo-formal të Grave,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, unë nuk po e shoh ZKKK-në këtu, sa i përket pikave të rendit të, ditës po e shpreh një shqetësim, nuk kam përputhshmeri me pikat e rendit të ditës të Kuvendit, përveç pikës 4. Draft-rregullorja për fshatra si dhe Draft-Stretegjia për informim mendoj që u desht me qen pika të rendit të ditës edhe në këtë Komitet. Nuk jam kundër pikave, po ju jap si sygjërim të konsultoheni me organet kompetente lidhur me pikat e rendit të ditës. Pra pika e 3 e rendit të ditës në Kuvend që është duhet të shtohet edhe këtu.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Pikat e rendit të ditës janë bërë me Kryesuesin e Kuvendit duke u konsultuar edhe me ZKKK-në, pika 3 mendoj që Komuniteti jo shumicë përfshihet në këtë Rregullore.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, mbase qenka në rregull, mirëpo te pika 3 edhe pasi që nuk e kemi materilain për me diskutuar, kemi munges të informacionit me diskutuar për këtë pikë propozoj pra te hedhet ne votim propozimi i Besnikut.

***Komiteti për Komunitete, me 2 vota "Për", me 4 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim", nuk e aprovon propozimin e Besnik Seferit, që pika 3 e rendit të ditës të Kuvendit "Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)" të jetë edhe pikë shtesë e rendit të ditës këtu në Komitetin për Komunitete.**

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Tani e hedhi në votim rendin e ditës që e keni pranuar me ftesë.

***Komiteti për Komunitete, me 5 vota "Për" , 0 vota "Kundër" dhe 1 votë "Abstenim" miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 28.10.2022

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Desha të ju korrigjoj nga mbledhja e kaluar, kur kam thënë që pika e 4 të hiqet nga rendi i ditës. Thirrja ka qenë e hapur për të gjitha gratë për sa i përket mamografit dhe nuk ka pasur kurrfarë diskriminimi. Konsideroj se kjo pikë kishte me qenë mirë me u futë në rendin e ditës, nëse do të kishim hasur në ndonjë diskriminim. Kjo është në faqen 1 për çka unë po flas.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 26.09.2022, me plotsimet e kërkuara nga znj.Rrezartë Ramadani.**

Pika 2

Përfshirja e komuniteteve në projektet kulturore, sportive dhe rinore

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Ajo çka po më shqetëson se organizatat e Komuniteteve po duhet me aplikuar për përkrahje nëpërmjet ZKKK-së e unë besoj se duhet të aplikojnë njëjtë sikur të tjerat drejtpërdrejt në DKRS.

z.Besnik Seferi; Të përgëzoj për këtë pikë. Mendoj edhe unë që është diskriminim kjo që niher me aplikuar në ZKKK, mandej me shku në DKRS. Nuk po ka çka me diskutuar mbase nuk po e kemi drejtoreshën këtu, gjitha pyetjet do ti adresojë edhe ne Kuvendin Komunal.

z.Muhamet Mehmeti; Kjo pikë shumë e duhur. Mundem me ju tegu që një organizat e Komunitetit ka fituar një projekt nga DKRS-ja, dhe nuk ka pasur asnjë lloj të diskriminimit. Pra të ju mundësohet familjeve të Komunitetit të përfshihen në Klubet Sportive. Për këtë e kisha bërë një Rekomandim.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë nuk e kam ditur që është hapur një organizat e tillë, kërkojë ndjesë që thash nuk ka përfituar askush.

z.Arton Demiri; Unë e kam djalë në Klubi Vjosa, 20 euro është pagesa, kurse ndërresat duhet me i ble vet. Ka nxënësa që kanë vullnet, por me qenë mundësia me pas lehtësira kishte me qenë mirë.

z.Besnik Seferi; Para se me i rekomanduar Drejtoreshës, kisha kërkuar përgjegjësi nga ajo dhe që duhet me qenë këtu. Sot ne mos me pas përfaqsim, për mos marrjen e përgjigjeve, unë kam me ba edhe një reagim publik, sepse po e shoh si një diskriminim që po i bëhet këtij Komiteti me mos pjesëmarrjen e drejtoreshës këtu.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Kjo ka qenë kërkesa jonë e drejtuar Krytarit, e ai na ka dhënë një premtim. E ata sërish nuk janë këtu.

***Komiteti, për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj DKRS-ë, që të përfshihet Komuniteti Rom dhe Ashkali në Klubet Sportive, dhe të gjindet mundësia e lehtësimit të pagesave për pjestarët e këtyre Komuniteteve.**

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kryetarit, që drejtorët e institucioneve lokale të përgjigjen ftesave të mbledhjeve të Komitetit, ose të japin informata me shkrim, si dhe Zyra për Informim të përcjell tekimet e Komitetit për Komunitete.**

***Komiteti për Komunitete, unanimsisht vendosi t'i Rekomandoj DKRS-së, që në kshillat organizative për manifestimet e ndryshme, të datave festive të ketë edhe së paku një anëtarë nga komunitetet Rom dhe Ashkali.**

Pika 3

Formimi i komisionit për hartimin e Planit-Punues për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hartimi i planit të punës, kemi pasur sugjerime që ta rregullojmë, e ta bëjmë më mirë, Kryesuesi më ka premtuar që ka me ma dërguar një kopje të Planit të Punës të Kuvendit për 2023. Unë kisha propozuar që të jenë të gjithë anëtarët e KPK-së si dhe ZKKK-ja pjesë e hartimit të këtij plani. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë pajtohem plotësisht me propozimin e Kryesuesit, ZKKK-ja me qen gjithmon se ajo ka me i dhënë jehonë planit të punës. Ne mundemi me kontribuar sa më shumë, edhe Ibrahim po ashtu sepse mendoj që jemi me vonesë. Do të ulemi për secilën pikë së bashku ta mendojmë mirë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Plani e ka kohën që në dhjetor të jetë gati për miratim, por nëse mendoni me e shty në Janar ne rregull është.

z.Muhamet Mehmeti; Ju të gjithë duhet me kanë prezent, do të ishte mirë, të punohet ngadalë dhe mirë, duhet me pas shumë ndryshime, besoj që kemi me ba një plan të punës të Komitetit për Komunitete shumë të mirë.

z.Arton Demiri; Është problem për mu, sot e kamë marr të lirë për me zëvendësua të shtunën.

***Komiteti për Komunitete unanimsisht, zgjodhi Komisionin për hartimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, në përbërje të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete së bashku me ZKKK-në, që takimi parë të mbahet me 9 dhjetor në ora 15:00h**

Pika 4

Diskutim për mundësinë e përfshirjes të një gruaje nga Komunitetet jo shumicë në Grupin Jo-formal të Grave

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ti sugjerojmë Kryesueses të Grupin Jo-formal të Grave që në këtë grup të përfshihet edhe një grua nga Komunitetet jo shumicë. Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Mendoj se është më rëndësi kjo, mua më vjen keq që nuk mu paska kujtuar për me paraqit këtë kërkesë. Nuk e besoj që ka me qenë problem, veçse jemi në muajt e par të këtij organizimi dhe kemi pasur disa takime më shumë njoftuese, pjesëmarrja e një gruaje nga Komunitete jo shumicë vec se i shton vlerat e grupit.

z.Besnik Seferi; Plotësisht pajtohna që të propozojmë edhe një grua nga Komunitetet jo shumicë në këtë grup jo formal, është një plan i mirë që të ndegjohet zëri i gruas së Komunitetit tonë. Propozoj që Shkurta Behluli të jetë anëtare e këtij grupi.

***Komiteti për Komunitete, unanimsisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit të Komunitetit të Shtimes, që të mundësojë përfshirjen në Grupin Jo-formal të Grave edhe e znj.Shkurte Behluli - Shtime nga Komuniteti pakicë, njëherit edhe anëtare e Komitetit për Komunitete.**

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Propozoj që sekretaria, për pikat e rendit të ditës të KPK-së të cilat janë të njëjta me pikat e rendit të ditës të Kuvendit të dërgohen materialet anëtarëve të KPK-së të cilët nuk janë pjesë e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Desha me ju sqaruar për pikën 4 të mbledhjes së kaluar të KPK-së, ideja ka qenë që ti kërkojmë regjionit të Ferizajt që Mamografin ta sjell në vendet ku ka Komunitet pakicë në Lagjet e Komunitetit. Në Ferizaj e di që e kanë bërë në këtë mënyrë Mamografin 100 gra.

znj.Rrezartë Ramadani; Thirrja ka qenë për të gjithë pa dallim e në Shtime, nuk ka ardhur Mamografi këtë herë, por u janë bërë ultrazë të gjirit e kur kanë hasur në ndonjë dyshim i kanë dërguar në mënyrë të organizuar në Ferizaj në Mamografi. Kurse furnizimi me lëndë djegëse me sa kam unë informata nuk ka pasur furnizim të asnjë familje.


z.Ibrahim Demiri, Përgjegjës i ZKKK; Nuk mundesh me bërë një kërkesë të till, sepse nuk ka mjete të planifikuara, rastet sociale që janë furnizuar janë ose me ndonjë donator. Kjo kërkon procedura dhe buxheti, kjo është e pa realizueshme, për këtë viti kemi pasur buxhet për këtë zyre 6500 euro.

z.Besnik Seferi; Unë mendojë se duhet me pas planifikim më herët, drutë janë me një kosto shumë të lart, duhet me ditë numrin e familjeve, e nëse ka ndonjë donatorë me dal në teren me pa gjendjen.

z.Arton Demiri; Vitin e kaluar na kemi shiquar prej orgazniatave tjera, sivjet kam arrit përmes një donatori nga Diaspora me ju dhënë tri familjeve nga një shporet dhe nga një metër dru.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11.37h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

